



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 746/2024

Datë: 11 korrik 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 11 korrik 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Z. Besnik Nuredini, prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, avancohet në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Ferizaj nga data 01 gusht 2024.
2. Obligohet z. Besnik Nuredini që të koordinohet me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për përfundimin e lëndëve të cilat i ka në punë.
3. Z. Besnik Nuredini ka të drejtë në beneficinet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore.
4. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur më datë 11 korrik 2024 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit KPK/KATPSH të datës 18 qershor 2024, ku pas shqyrtimit të të njëjtit raport, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'i dërgohet:

- Z. Besnik Nuredini;
- Kryeprokurorit të PTH Ferizaj;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.